



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 32 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 3267 prot., datë 18.06.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në lidhje me informacionin e kërkuar për pyetjet nga numri 1 deri në numrin 8 nga të dhënat e përcjella nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rezultojnë si vijon:

**1. Cili është numri i çështjeve civile dhe penale të regjistruara dhe të pa shqyrtuara (backlog) në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në muajin qershor 2024?**

Numri i çështjeve penale dhe civile të regjistruara deri në datën 20.06.2024, në total janë 39.768 çështje, nga të cilat:

- Nr.12619 çështje penale
- Nr.27149 çështje civile

**2. Cili ishte numri i çështjeve civile dhe penale të regjistruara dhe të pa shqyrtuara (backlog) nga 6 Gjykatat e Apelit në datën 31.01.2023?**

Numri i çështjeve penale dhe civile të regjistruara deri në datën 31.01.2023, në total janë 33.731 çështje, nga të cilat:

- Nr. 9845 çështje penale
- Nr. 23.886 çështje civile

**3. Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet civile dhe penale të 6 Gjykatave të Apelit të ndryshuara nga Gjykata e Lartë në vitet 2021, 2022 dhe periudhën 01.01.2023- 31.01.2023?**

Informacioni që disponohet është për Gjykatën e Apelit Tiranë, për vitet 2021, 2022, si dhe për vitin 2023 të Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga të cilat rezultojnë:

- Për vitin 2021, ka në total 113 çështje (92 civile / 21 penale) nga të cilat 5 të ndryshuara civile, 87 çështje civile të prishura/kthim për rigjykim dhe 21 të prishura/kthim për rigjykim penale.
- Për vitin 2022, ka në total 212 çështje (160 civile / 44 penale, 8 masa sigurimi) nga të cilat 1 e ndryshuar civile dhe 159 prishur/kthim për rigjykim dhe 52 të prishura/kthim për rigjykim.
- Për vitin 2023, ka në total 523 çështje (419 civile / 104 penale) nga të cilat 1 civile e ndryshuar dhe 418 civile prishur/rigjykim, 104 penale të prishura/kthim për rigjykim.

Nga Zyrat e Shërbimit të ngritura pranë ish-gjykatave të Apelit Gjirokastrë, Korçë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër, nuk disponohet informacion lidhur me numrin e vendimeve të gjykatave respektive të apelit, të ndryshuara nga Gjykata e Lartë për vitet 2021, 2022 dhe për muajin Janar 2023.

**4. Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet civile dhe penale të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të ndryshuara nga Gjykata e Lartë për periudhën 01.02.2023- 31.12.2023 dhe në vitin 2024?**

Nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Zyrat e Shërbimit të ngritura pranë ish-gjykatave të Apelit Gjirokastrë, Korçë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër, nuk disponohet informacion lidhur me numrin e vendimeve të gjykatave respektive të Apelit, të ndryshuara nga Gjykata e Lartë për vitet 2021, 2022 dhe për muajin Janar 2023.

**5. Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet civile dhe penale të Gjykatave të Apelit të prishura dhe të dërguara për rigjykim nga Gjykata e Lartë në vitet 2021, 2022 dhe periudhën 01.01.2023- 31.01.2023?**

Informacioni që disponohet është për Gjykatën e Apelit Tiranë, për vitet 2021, 2022, si dhe për vitin 2023 të Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga të cilat rezultojnë:

- 191 vendime civile të prishura/kthim për rigjykim janë të Gjykatës të Apelit Tiranë, 76 vendime civile të prishura/kthim për rigjykim janë të Gjykatës të Apelit Vlorë
- 57 vendime civile të prishura/kthim për rigjykim janë të Gjykatës të Apelit Durrës, 32 vendime civile të prishura/kthim për rigjykim janë të Gjykatës të Apelit Shkodër, 12 vendime civile të prishura/kthim për rigjykim janë të Gjykatës të Apelit Korçë, 29 vendime civile të prishura/kthim për rigjykim janë të Gjykatës të Apelit Gjirokastrë
- Për çështje penale ka në total 104 çështje penale të prishura/kthim për rigjykim, nga të cilat: 54 janë të gjykatës të Apelit Tiranë, 18 të Apelit Vlorë, 16 të Apelit Durrës, 3 të Apelit Gjirokastrë, 6 të Apelit Korçë, 7 Apelit Shkodër.

Nga Zyrat e Shërbimit të ngritura pranë ish-gjykatave të Apelit Gjirokastrë, Korçë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër, nuk disponohet informacion lidhur me numrin e vendimeve

të gjykatave respektive të Apelit, të ndryshuara nga Gjykata e Lartë për vitet 2021, 2022 dhe për muajin Janar 2023.

**6. Cili është numri dhe përqindja e vendimeve për çështjet civile dhe penale të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të prishura dhe të dërguara për rigjykim nga Gjykata e Lartë për periudhën 01.02.2023-31.12.2023 dhe në vitin 2024?**

(Referohuni përgjigjes së pyetjes nr.3)

Për vitin 2024 në total janë 226 çështje civile të prishura/ të kthyer për rigjykim, nga të cilat 25 të Gjykatës të Apelit Durrës, 16 të Gjykatës të Apelit Gjirokastrë, 11 të Gjykatës të Apelit Korçë, 9 të Gjykatës të Apelit Shkodër, 41 të Gjykatës së Apelit Vlorë, 124 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për vitin 2024 në total janë 103 çështje penale të prishura/ të kthyer për rigjykim, nga të cilat 25 të Gjykatës të Apelit Durrës, 10 të Gjykatës të Apelit Korçë, 9 të Gjykatës të Apelit Shkodër, 19 të Gjykatës së Apelit Vlorë, 40 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

**7. Cili është numri mesatar i vendimeve të disponuara nga gjyqtarët e 6 Gjykatave të Apelit në vitet 2021, 2022 dhe periudhën 01.01.2023-31.01.2023?**

- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në total për vitin 2023 (nga data 1 shkurt) është **8.215** çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Tiranë në Janar për vitin 2023 është 224 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Tiranë në total për vitin 2022 është 3305 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Tiranë në total për vitin 2021 është 2699 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Shkodër në total për muajin Janar 2023 është 81 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Shkodër në total për vitin 2022 është 1826 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Shkodër në total për vitin 2021 është 2713 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Vlorë në total për muajin Janar 2023 është 129 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Vlorë në total për vitin 2020 është 2161 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Vlorë në total për vitin 2021 është 2865 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Vlorë në total për vitin 2022 është 2383 çështje gjyqësore.

- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Durrës në total për muajin Janar 2023 është 110 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Durrës në total për vitin 2022 është 2018 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Durrës në total për vitin 2021 është 2426 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Korçë në total për muajin Janar 2023 është 34 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Korçë në total për vitin 2022 është 717 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Korçë në total për vitin 2021 është 960 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë në total për muajin Janar 2023 është 17 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë në total për vitin 2022 është 660 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë në total për vitin 2021 është 948 çështje gjyqësore.

**8. Cili është numri mesatar i vendimeve të disponuara nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 01.02.2023- 31.12.2023 dhe në vitin 2024?**

- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në total për vitin 2023 (nga data 1 shkurt) është 8.215 çështje gjyqësore.
- Numri i çështjeve të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në total për vitin 2024 (deri në datën 20 Qershor) është 4776 çështje gjyqësore.

Në lidhje me informacionin e kërkuar për pyetjet nr. 9 dhe nr. 10 nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore (bashkëlidhur të dhënat i gjeni edhe në format tabelar) rezulton si vijon:

**9. Cili ka qenë numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të miratuar në organikën e 6 Gjykatave të Apelit në vitet 2021 dhe 2022? Cili ka qenë numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të emëruar në organikën e 6 Gjykatave të Apelit për vitet 2021 dhe 2022? Cili ka qenë numri i vakancave në 6 Gjykatat të Apelit në vitet 2021 dhe 2022?**

- Për vitin 2021, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve dekretuar nga Presidenti i Republikës në 6 Gjykatat e Apelit ka qenë 78 (shtatëdhjetë e tetë), organika në fakt ka qenë 50 (pesëdhjetë), efektivisht në detyrë kanë qenë 29 (njëzet e nëntë), vakancat e përhershme kanë qenë 28 (njëzet e tetë) dhe vakancat e përkohshme kanë qenë 21 (njëzet e një).

- Për vitin 2022, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve dekretuar nga Presidenti i Republikës në 6 Gjykatat e Apelit ka qenë 78 (shtatëdhjetë e tetë), organika në fakt ka qenë 45 (dyzet e pesë), efektivisht në detyrë kanë qenë 30 (tridhjetë), vakancat e përhershme kanë qenë 33 (tridhjetë e tre) dhe vakancat e përkohshme kanë qenë 15 (pesëmbëdhjetë).

**10. Cili ka qenë numri i përgjithshëm i gjyqtarëve i miratuar në organikën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitet 2023 dhe 2024? Cili ka qenë numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të emëruar në organikën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitet 2023 dhe 2024? Cili ka qenë numri i vakancave në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitet 2023 dhe 2024?**

- Për vitin 2023, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve dekretuar nga Presidenti i Republikës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka qenë 78 (shtatëdhjetë e tetë), organika në fakt ka qenë 34 (tridhjetë e katër), efektivisht në detyrë kanë qenë 25 (njëzet e pesë), vakancat e përhershme kanë qenë 44 (dyzet e katër) dhe vakancat e përkohshme kanë qenë 9 (nëntë).
- Për vitin 2024 deri aktualisht, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve dekretuar nga Presidenti i Republikës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është 78 (shtatëdhjetë e tetë), organika në fakt është 32 (tridhjetë e dy), efektivisht në detyrë janë 26 (njëzet e gjashtë), vakancat e përhershme janë 46 (dyzet e gjashtë) dhe vakancat e përkohshme janë 6 (gjashtë).

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!